



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 1111 Prot.

Tiranë, më: 07 . 02 . 2020

Vendimi 05

REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI :

Mos pajisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k.

Nr. NIPT-i: L72031013B

Adresa e selisë: Njësia Administrative Nr .5, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nr. 48, Tiranë.

Personi përgjegjës: Giuseppe Ciaffaglione

Për të zhvilluar projektin “**Landfill i mbetjeve të rrezikshme jo radioaktive**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I: Pika 9. Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

Vendndodhja: Zona e Trajtimit të Mbetjeve, Sharrë, Tiranë

(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:

- Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënavë kadastrale për pyjet dhe kullotat.
- Në raportin e thelluar të VNM-së subjekti nuk ka mbajtur parasysh sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtonte në raportin e thelluar të VNM-së sa i takon menaxhimit të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- Nuk janë mbajtur parasysh përcaktimet e VKM-së nr. 247, datë 30.04.2015 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

2. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

- Projekti “Landfill i mbetjeve të rrezikshme jo radioaktive” nuk është pjesë e Kontratës së Koncesionit “Për Ndërtim Landfill, Inceneratori dhe Rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e Energjisë Elektrike”, ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. me Nr. 6597 prot datë: 31.08.2017.
 - Bazuar në kodet e mbetjeve, nuk specifikohet:
 1. mënyra e ndarjes së tyre sipas llojit, bazuar në kodin e mbetjes
 2. sasi të e parashikuara sipas kodeve të mbetjeve
 2. mënyra e stacionimit, kapsulimit dhe depozitimit të tyre në landfill.
 - Nuk jepen specifikat e impiantit të trajtimit të shllamit, lloji dhe kapaciteti i tij
 - Për sa i përket procedurës së dëgjësës me publikun, ajo është kryer për projektin “Për Ndërtim Landfilli, Inceneratori dhe Rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e Energjisë Elektrike”, në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve, ku aplikimi për “Landfill i mbetjeve të rrezikshme jo radioaktive”, nuk ka qënë pjesë e prezantimit
- Për sa më sipër, janë mbajtur parasysh përcaktimet e VKM-së nr. 247, datë 30.04.2015 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, KREU II i saj.

DREJTORI I PËRGJITHSHËMI AKM

EDISON KONOMI

MINISTRI
BLENDI KLOSI



1. Anex 1. Harta dhe koordinat

